

TË DREJTAT THEMELORE TË EMIGRANTËVE NË MAQEDONI

Në Nenin 29 të Kushtetutës së RM-së është përcaktuar se në territorin e shtetit, të huajt gëzojnë liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutën, me kushte të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

RM është nënshkruese e pjesës më të madhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, ndërsa të drejtat e emigrantëve janë përfshirë dhe me ligjet mbi të huajt, mbi azilin dhe mbrojtjen e përkohshme dhe të procedurës së përgjithshme administrative, nëpërmjet të cilëve emigrantëve u garantohen të drejtat në vijim:



1. TË DREJTAT MINIMALE CIVILE DHE POLITIKE



- **E drejta e jetës:** autoritetet nuk guxojnë të përdorin një forcë të paarsyeshme gjatë përpjekjeve për t'i ndaluar emigrantët nga hyrja në vend dhe kanë për obligim të orvaten t'i shpëtojnë jetët e atyre që janë të rrezikuar me hyrjen në vend
- **Mbrojtja nga torturimi dhe trajtimi jonjerëzor ose poshtëruës ose nga dënimi:** Autoritetet janë të detyruar të parandalojnë dhe t'i mbrojnë nga torturimi gjithë personat që janë të privuar nga liria dhe gjenden në territorin e tyre. Gjatë dëbimit nga vendi, është i obligueshëm respektimi i të drejtës së dinjitetit, ndërsa masat detyruese duhet reduktuar në minimum
- **E drejta e lirisë:** arrestimi mund të aplikohet vetëm si mjet i fundit, dhe duhet të miratohet nga Gjykata dhe të mos zgjasë jashtë mase
- **Mbrojtja nga robëria dhe puna e detyruar**
- **E drejta e azilit dhe ndalimi i dëbimit të detyruar gjatë procedurës**
- **E drejta e mjetit të efektshëm juridik përpara dëbimit:** patjetër duhet siguruar para një organi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, i cili do të mundësojë interpretimin dhe përkthimin
- **Respektimi i jetës private dhe familjare:** Nuk guxon të ketë dëbim aty ku ekzistojnë "lidhje posaçërisht të fuqishme"
- **E drejta e barazisë:** nuk guxon të ekzistojë diskriminimi gjatë shfrytëzimit të të drejtave ose diskriminimi në bazë të racës ose përkatësisë etnike gjatë pranimit, qëndrimit dhe dëbimit
- **E drejta e korrespondencës**

2. TË DREJTAT MINIMALE EKONOMIKE DHE SOCIALE



- **E drejta e banimit dhe sistemimit të përshtatshëm** e cila do ta garantojë dinjitetin themelor të njeriut
- **E drejta e ndihmës mjekësore**, përfshirë këtu dhe ndihmën psikologjike
- **E drejta e mbrojtjes sociale për ruajtjen e dinjitetit të njeriut:** fëmijëve emigrant duhet t'u sigurohen po të njëjtat të drejta sikurse fëmijëve me nënshtetësi të Maqedonisë
- **E drejta e arsimit fillor dhe të mesëm**
- **E drejta e ndihmës humanitare**